



# **“TIRANA DIGJITALE”: PROJEKTET ZHVILLIMORE QË SYNOJNË TA SHNDËRROJNË KRYEQYTETIN NË LIDER RAJONAL NË FUSHËN E INOVACIONIT DERI NË 2030**

Tirana është në një rrugë të qartë drejt shndërrimit të saj në një lider rajonal në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, me objektivin ambicioz për ta arritur këtë brenda vitit 2030. “Tirana Digjitale” përfshin një sërë projektesh që synojnë modernizimin e ekonomisë dhe shërbimeve të qytetit, duke vendosur një fokus të veçantë te rinia dhe zhvillimi i startup-eve.

Një ndër shtyllat kryesore të këtij plani është krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm për inovacionin dhe teknologjinë, që do të promovohet përmes platformës “Digital Tirana”. E lançuar në vitin 2021 dhe aktive që nga marsi 2022, kjo platformë është një urë lidhëse midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit teknologjik, duke ofruar informacione për financimet, hapësirat bashkëpunuese, inkubatorët dhe mundësitë për të rinjtë dhe nomadët digjitalë.

“Digital Tirana” është ndërtuar për t’iu përgjigjur nevojave të startup-eve dhe komunitetit rinor në Tiranë, duke ofruar një bazë të dhënash me informacione të detajuara mbi startup-et, investitorët dhe aktorët e tjerë të ekosistemit.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është “Strategjia e Digjitalizimit dhe Inovacionit” e hartuar nga Bashkia Tiranë në vitin 2023. Kjo strategji, përveç modernizimit të shërbimeve publike dhe proceseve të brendshme, vendos në fokus inovacionin dhe mbështetjen për startup-eve rinore. Ajo përfshin edhe krijimin e një programi të posaçëm për identifikimin, këshillimin dhe financimin e startup-eve për t’i ndihmuar ato të shndërrohen në biznese të suksesshme.

Angazhimi për ta shndërruar kryeqytetin në një qendër teknologjike rajonale lidhet drejtpërdrejt me synimet dhe standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Kapitullin 19 (Politikat Sociale dhe Punësimi) dhe Kapitullin 26 (Arsimi dhe Kultura) të domosdoshme për integrimin në Bashkimin Evropian.

Sipas Kapitullit 19 BE-ja kërkon përmirësimin e politikave sociale dhe të punësimit, përfshirë nxitjen e sipërmarrjes dhe punësimit për të rinjtë. Në këtë drejtim, “Tirana Digjitale” po mbështet inovacionin dhe startup-et përmes grantesh, kredive të buta dhe krijimit të rrjeteve për ndërmjetësim dhe këshillim. Kjo nismë synon të krijojë mundësi punësimi dhe vetëpunësimi për të paktën 1,000 të rinj deri në vitin 2027, të përcaktuar në dokumentin zhvillimor.

Nga ana tjetër, Kapitulli 26 thekson përmirësimin e arsimit dhe promovimin e kulturës, ku përfshihet zhvillimi i aftësive digjitale dhe inovacioni. “Tirana Digjitale” ofron qasje në mundësi mësimore të vazhdueshme ku ndër projektet më të suksesshme mund të përmendet projekti i “TUMO Tirana”, që me kurset profesionale zhvillon aftësitë e të rinjve dhe i përgatit për tregun e punës.

Element kyç i vizionit të “Tiranës Digjitale” është përfshirja e të rinjve në proceset e inovacionit dhe teknologjisë. Me programe si “Hackathon Junction” dhe “Festa e Inovacionit”, të rinjtë kanë përpara tyre mundësinë për të ndarë ide dhe të angazhohen në aktivitete që promovojnë mendimin kritik dhe zgjidhjet inovative për sfidat e qytetit.

“Tirana Digjitale” është një vizion të qartë për të ardhmen e qytetit, që synon jo vetëm rritjen ekonomike, por edhe përfshirjen aktive të të rinjve në këtë proces. Nisma ka prodhuar rezultate të qarta në zhvillimin e startup-eve dhe sipërmarrjeve të reja, duke e kthyer Tiranën në një “hotspot” rajonal edhe për nomadët digjital, duke kontribuar edhe në përshpejtimin e aspiratave evropiane të Shqipërisë.